



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9.5.2023

Nr: 472

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 392, NGA KOALICIONI BASHKË FITOJMË PËR AFISHIMIN E MATERIALIT PROPAGANDISTIK TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" NË RRUGËN NACIONALE ELBASAN-LIBRAZHD, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 9 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Koalicioni Bashkë Fitojmë

OBJEKTI: Kërkohet heqja e materialit propagandistik të vendosur në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, neni 79, pika 3, tëKodit Zgjedhor, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 392 ID, datë 6.5.2023, me denoncues Koalicioni Bashkë Fitojmë.

Koalicioni Bashkë Fitojmë pretendon se "Në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, pranë Restorant Balla, Labinot Fushë, në një tabelë është konstatuar afishimi i materialit propagandistik me përmasa të përafërta 10 m të gjatë dhe 3 m të gjërë, në kundërshtim të ligjit dhe udhëzimet e nxjerra prej tij, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë".

Data: 9.5.2023 Nr: 472
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 392, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë për afishimin e materialit propagandistik të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023"

Pala kërkuese kërkon nxjerrjen e një vendimi sa më të shpejtë për heqjen e materialit propagandistik të vendosur në Rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, pranë Restorant Balla, Labinot Fushë.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesit. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar nga monitoruesi i caktuar nga KQZ për monitorimin e Bashkisë Elbasan, nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion në lidhje me afishimin e këtij materiali propagandistik. Nga informacioni i dërguar nga monitoruesi rezultoi se materiali propagandistik është vendosur në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd dhe nuk përmban shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të” (vijon emri i subjektit zgjedhor).

Gjithashtu nëpërmjet e-mail të datës 6.5.2023, i është kërkuar subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, marrja e masave të menjëhershme për heqjen e materialit propagandistik.

Në datë 3.5.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miratoi vendimin nr. 424, “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor) nëpërmjet të cilit ngarkohet policia e shtetit dhe policia bashkiake për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të cilat nuk përmbajnë këtë shënim. Ky vendim i adresohet të gjithë subjekteve zgjedhore që nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor, dhe ngarkon policinë bashkiake dhe policinë e shtetit për zbatimin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Vendimi nr. 424, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i është përcjellë të gjitha bashkive si dhe Policisë së Shtetit me shkresat nr. 4640 Prot. dhe nr. 4651 Prot., datë 4.5.2023.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raportit të monitorimit vlerësojmë se materiall propagandistik është vendosur në kundërshtim të pikës 3, të nenit 79, të Kodit Zgjedhor,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f ” dhe “n”, e pika 2, nenin 79, pika 3, të Kodi Zgjedhor dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Elbasan për heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në rrugën nacionale Elbasan-Librazhd pranë Restorant Balla, Labinot Fushë.
2. Ngarkohen Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Elbasan për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.

Data: 9.5.2023 Nr: 472
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 392, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë për afishimin e materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

3. Ky vendim t'u njoftohet subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake Elbasan nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 9.5.2023 Nr: 472
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 392, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë për afishimin e materialit propagandistik të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në rrugën Nacionale Elbasan-Librazhd, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023"